

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 31.01.2025*

**31.01.2025**

**Ora 12:06**

***RENDI I DITËS***

***Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të disa institucioneve për periudhën 19 janar – 25 janar 2025.***

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafi KQZ: Znj. P. Doçaj, znj. A. Nasto**


**Parti Politike: Nuk ka**

**Të tjerë: Nuk ka**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite shqyrtime administrative në lidhje me veprimtaritë publike të disa institucioneve publike për periudhën 19 janar – 25 janar 2025. Po, Pavlina.

**Znj. P. Doçaj:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin e datës 28.01.2025 ka vendosur fillimin e procedimit administrativ ndaj 14 institucioneve. Nisur nga ky vendim nga ana e administratës së KQZ-së iu është bërë me dije dhe u janë kërkuar prova, pra ka filluar shqyrtimi administrativ dhe hetimi ndaj këtyre institucioneve. Kryesisht, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari jashtë afateve ligjore. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari po jashtë afateve ligjore. Banka e Shqipërisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve një veprimtari përtej afateve ligjore. Po kështu Bashkia

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 31.01.2025*

Elbasan përtej afateve ligjore. Bashkia Roskovec një veprimtari përtej afateve ligjore. Bashkia Sarandë ka raportuar në ndërfaqe dy veprimtari, të dyja jashtë afateve ligjore. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve dy veprimtari përtej afateve ligjore. Korporata e Investimeve Shqiptare ka raportuar në ndërfaqe një veprimtari jashtë afateve ligjore. Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor ka raportuar në ndërfaqe katër veprimtari jashtë afateve ligjore. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka raportuar dy veprimtari jashtë afateve ligjore. Ministria e Financave ka raportuar tre veprimtari jashtë afateve ligjore. Zyra Vendore Arsimore Elbasan ka raportuar në ndërfaqe një veprimtari jashtë afateve ligjore. Bashkia Mat një veprimtari jashtë afateve ligjore. Bashkia Cërrik një veprimtari jashtë afateve ligjore. Për sa i përket provave, të gjitha janë përgjigjur me email, pra kanë justifikuar në pjesën më të madhe të institucioneve, faktin që, në rastet kur kanë qenë e ndaluar nga ana e KQZ-së, pjesa më e madhe janë anuluar dhe janë zhvilluar më pas si veprimtari dhe në pjesën më të madhe të tyre janë veprimtari të cilat nuk do të duhet t'i deklaronin në ndërfaqe sepse janë thjesht të ftuar. Pra për shkak të parashikimeve të ligjit nuk hyjnë në ato veprimtari të cilat do të duhet të raportoheshin në ndërfaqe.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord. Me përjashtim të Bashkisë Cërrik, për të gjitha institucionet e tjera publike do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ. Atë të Bashkisë Cërrik do ta shtyjme vendimmarrjen për një ditë tjetër, dakord. Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi. Faleminderit! Seanca mbyllet.

**Vendimi nr. 49-60**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

